

## POEZISË

Dashuria ime e parë dhe e fundit!  
Poezia ime që më rroke fëmi,  
Unë s'të zgjodha, qe ti që m'përkunde,  
Ke qenë ti që më bëre magji.

Të shikoja të hirshmen fytyrë,  
Po një vel të mbulonte gjithnjë  
Dhe tiparet e tua në pasqyrë  
Unë i shihja, veç kaq e asgjë më.

Dhe me dorën time të paduruar  
Gjithnjë desha të të grisja atë vel  
Porsi dhëndri afshit përvëluar  
Pret që nusja atë gji t'ia çelë.

Po si gur bëhej vel i butë  
Edhe etja më digjte si zjarr.  
Kur do t'më çelësh bukurinë prej fluture?  
Do zhuritem kështu gjer në varr?

Pres me ankth që koha të rendë,  
Pres një çast, veç një çast dhe më  
asgjë  
Kur ai vel i lehtë e aq i rëndë  
Do të ngrihet e s'do t'ulet më.

## ALLA POESIA

O mio primo e mio ultimo amore!  
Mia poesia che, bimba, mi abbracciasti.  
Non ti scelsi, a cullarmi tu fosti,  
Fosti tu a farmi un incantesimo.

Ti vedeva l'incantevole viso,  
Ma un velo ti copriva sempre,  
I lineamenti tuoi intravedevo,  
Solo questo e niente di più.

E colla mia mano impaziente  
Ti volevo strappare quel velo.  
Come uno sposo tutto ardente  
La sua sposa attende che apra  
il seno.

Ma il morbido velo diveniva  
Pietra e mi tormentava la sete.  
Quando vedrò la tua bellezza di farfalla?  
O arderò così fino alla tomba?

Solo aspetto che il tempo scorra,  
Solo aspetto che venga un istante  
Quando il velo leggero e pesante  
Si alzerà e non si abbassera più.